

| | | | |
|---|-------|-----------------------------------|-----------------|
| REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH | | | |
| Njësia Org. Org.Jedimica Org Unit | 02 | Nr.Prot: Serj Prot: Prot.No | 05-9907 |
| Nr.i faqeve Br.stranica No.pages | - 4 - | Data: Datum: Date: | 18 / 12 / 20 24 |
| Prishtinë / a | | | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE (PSO)

EMRI I PSO: RAPORTIMI DITOR I SITUATËS SË SHPËRTHIMIT TË SËMUNDJES

PËRMBAJTJA: PËRSHKRIMI I PROCEDURAVE QË DUHEN NDJEKUR PËR PËRPILIMIN DHE SHPËRNDARJEN E RAPORTIT DITOR TË SITUATËS SË SËMUNDJEVE.

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT: 17.12.2024
AUTOR: MSn
NR. I HAPAVE: I/
NR. I NËNHAPAVE: 03

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



| | |
|---------------------|--|
| QËLLIMI | KRIJIMI I NJË PROCESI TË QËNDRUESHËM PËR GRUMBULLIMIN, HULUMTIMIN DHE ANALIZËN E TË DHËNAVE, HARTIMIT TË RAPORTIT DITOR DHE SIGURIMIT TË SAKTËSISË DHE PLOTËSISË PËRPARA DORËZIMIT |
| NDËRLIDHJA ME AKTET | <ul style="list-style-type: none"> • LIGJI PËR SHËNDETËSI NR. 04/L-125 • LIGJI NR.08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE |
| LISTA E SHKURTESAVE | MSH-MINISTRIA E SHËNDETËSISË IKSHPK-INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE QOESHP-QENDRAT OPERATIVE EMERGJENTE TË SHËNDETIT PUBLIK |

PROCEDURA

| Nr | HAPI | NËN-HAPAT |
|-----|--|--|
| I | Verifikimi dhe konfirmimi i informatës | <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialisti/ekipi i Departamentit të Epidemiologjisë IKSHPK/QRSHP e kontakton burimin e informatës me qëllim të konfirmimit dhe verifikimit të informatave preliminare përmes bisedës me personin që e ka zbuluar dhe raportuar dyshimin (mjeku, pacienti, familjari, qytetari, media, etj).; 2. Pas konfirmimit të informatës njoftohet Drejtori i IKSHPK-së dhe njëkohësisht vazhdon grumbullimi fillestar i të dhënave për rastin/ngjarjen; 3. Në rast se konfirmohet se të dhënat paraqesin rrezik në aspektin e shëndetit publik dhe varësisht nga natyra e kërcënimit, IKSHPK kontakton institucione të tjera relevante dhe bëhet një vlerësimi i shpejtë i riskut. |
| II | Hulumtimi i rasteve | <ol style="list-style-type: none"> 1. Pas konfirmimit të ngjarjes, nga ekipi hulumtues grumbullohen të dhënat fillestare nga burimi/burimet në dispozicion me qëllim të identifikimit të kërcënimit. |
| III | Analiza e të dhënave | <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat e grumbulluara analizohen me metodën deskriptive (person, vend, kohë) si dhe karakteristikat e tjera epidemiologjike relevante (që janë në dispozicion) me qëllim të hartimit të Raportit Preliminar të situatës aktuale. |
| IV | Përpilimi i raportit dhe ndërmarrja e masave | <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialisti/ekipi që ka bërë grumbullimin, hulumtimin dhe analizën e të dhënave përpilon Raportin, i cili duhet të përmbajë: <ol style="list-style-type: none"> a. hytjen-mënyrën si është detektuar ngjarja; b. të dhënat mbi ngjarjen (vendin e ngjarjes, kohën e ndodhjes, natyrën e ngjarjes, personat e përfshirë); c. detajet: numri i rasteve të infektive/vdekjeve, shpërndarja gjeografike; d. data dhe koha e paraqitjes së rasteve të para; e. informacioni bazë klinik-simptomat, manifestimi klinik, numri i të spitalizuarve; f. ashpërsia e sëmundjes; g. rezultatet laboratorike; h. masat e ndërmarra. 2. Raporti ditor me masat e ndërmarra i dërgohet drejtorit të IKShPK-së, QOShP dhe Menaxherit të Incidentit, të cilat |

| | | |
|--|--|---|
| | | <p>njoftojnë MSh dhe autoritetet relevante varësisht nga natyra e ngjarjes;</p> <p>3. Raporti ditor përditësohet në baza ditore varësisht nga zhvillimi i ngjarjes dhe ruhet në bazën e të dhënave të IKSHPK.</p> |
|--|--|---|